



VENDIM

Nr.47 Datë 17.04.2015

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PER LICENSIM E SHOQERISE
“MESOPOTAM ENERGJI” SH.P.K., NE AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE NGA HEC “DRIZA” ME
FUQI TOTALE 3.408 MW.**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”; 9 dhe 13 pika 1, gërma “d” të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “g”; 5 pika 2; 8, 10/3 ; të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 17.04.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “**MESOPOTAM ENERGJI**” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike te kësaj shoqërie nga Hec ”Koxheraj”,

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “Mesopotam Energji” sh.p.k. sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

Neni 9, pika 1, Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte

Neni 9, pika 2 Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronesor është plotësuar teresisht.

Neni 9, pika 3 Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar teresisht.

Neni 9, pika 4.1.1 Është plotësuar teresisht.

Neni 9, pika 4.1.2 Është plotësuar teresisht.

Neni 9, pika 4.1.3 Është plotësuar teresisht.

Neni 9, pika 4.1.4 Dokumentacioni tekniko- ekonomik eshte plotesuar pjeserisht (Nuk eshte paraqitur vleresimi i MEI-it per oponenten teknike te AKBN.)

Neni 9, pika 4.1.5 Leje nga institucione te tjera. Eshte plotesuar pjeserisht.

Per dokumentacionet e munguara, do te njoftohet subjekti qe ne baze te “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit te Plote/te Pjesshem dhe Rinovimit te Licensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, ti paraqese keto ne ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave per licensimin e shoqerise “MESOPOTAM ENERGJI” sh.p.k., ne aktivitetin e prodhimit te energjise elektrike nga Hec “Driza” me fuqi totale 3.408 MW .
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve te ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s
Petrit AHMETI